



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
SENATI AKADEMIK

Nr. 417/6 prot.

Elbasan, me 23.02.2024

VENDIM

Nr 12 datë 23.02.2024

Për pagesën e orëve suplementare të vitit akademik 2023-2024

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 " Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, Udhëzimit nr. 29, datë 10.09.2018, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në IAL", Senati Akademik në mbledhjen e Tij të datës 23.02.2024

VENDOSI:

1. Personelit akademik të punësuar me kohë të plotë t'i paguhen deri në 300 orë suplementare të realizuara mbi normën e ngarkesës në auditor për vitin akademik 2023-2024, pasi të ketë përmbushur kohën minimale vjetore të punës prej 1,536 orë.
2. Fondi për këtë pagesë të përballohet nga granti i parashikuar për shpenzimet e pagave të punonjësve për vitin 2024.
3. Vendimi i Senatit Akademik i dërgohet Bordit të Administrimit të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" për procedurat miratimit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Skender Topi

